



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 197/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Nenad Lazić dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjore Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Behar Hashani nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Obiliq, paraqitur kundër Bujar Bajramit anëtar i Këshillit të Vendvotimit (KVV) në Plemetin komuna e Obiliqit, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr. 197/2017 e datës 11.06.2017 parashtruar nga Behar Hashani nga subjekti politik LDK dega në Obiliq

A r s y e t i m

Me datën 11.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Behar Hashani nga subjekti politik LDK dega në Obiliq në të cilin thekson se Bujar Bajrami e fotoqrafj votën.

Paneli, pasi që shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se Bujar Bajrami e fotoqrafj votën Paneli, vlerëson se ankesa e parashtruar është e pa bazuar ngase parashtruesi i ankesës, pretendimet ankimore nuk i ka mbështetur me asnjë provë materiale, e cila do ti vërtetonte pretendimet e tij, andaj, PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 197/2017 më datën 12.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.